




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

### Zyra për Informim

|                              |                                                                                                                        |
|------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Data/Date:</b>            | 30.09.2025                                                                                                             |
| <b>Nga/Od/From</b>           | Grupi Punues për Dëgjime Buxhetore                                                                                     |
| <b>Për/Za/To:</b>            | Kryetar i Komunës, z. Fadil Nura                                                                                       |
| <b>CC</b>                    | Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Skenderajt, znj. Adelina Spahiu                                                       |
| <b>Tema/Subjekat/Subject</b> | Raporti për ecurinë e dëgjimeve buxhetore për projekt-buxhetin 2026 si dhe parashikimet e buxhetit për vitin 2027-2028 |

Duke u bazuar në nenin 22, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, nenin 30, nenin 31 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, hartohet ky raport:

Me 06.03.2025, Kryetari i Komunës, z. Fadil Nura ka formuar Grupin Punues për Dëgjime Buxhetore, në këtë përbërje:

1. **Ismet Aliu** – Drejtor për Buxhet dhe Financa, kryesues;
2. **Besart Geci** – Zyrtar Kryesor Financiar, anëtar;
3. **Amir Lushtaku** – Udhëheqës i Zyrës për Informim, anëtar;
4. **Driton Mula** – Drejtor për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, anëtar;
5. **Besarta Meha**- Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik, Ndërmarrësi, Inovacion dhe Turizëm, anëtare;
6. **Bebxhet Maliqi** – Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar;
7. **Kastriot Duraku** – Drejtor i Drejtorisë për Arsim, anëtar;
8. **Shahin Tahiri** – Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, anëtar;
9. **Alban Berisha** – Drejtor për Kulturë Rini dhe Sport, anëtar;
10. **Alban Shala** – Drejtor për Shërbime Publike, anëtar.

### Takimet

Me 15.08.2025, është mbajtur takimi i Grupit Punues i udhëhequr nga Kryesuesi i Grupit, z. Ismet Aliu dhe në pjesëmarrje të të gjithë anëtarëve tjerë, në këtë takim u prezantua projekt-buxheti 2026 si dhe

parashikimet e buxhetit për vitin 2027-2028 për Komunen e Skenderajt i cili është hartuar në bazë të Qarkores Buxhetore 2026/01 dhe 2026/02 për Komunitat lëshuar nga Ministria e Financave, dhe në koordinim me propozimet e drejtorive komunale. Në këtë takim anëtarët kanë diskutuar për rëndësinë e projekt-buxhetit 2026 dhe parashikimet e buxhetit për vitin 2027-2028. Grupi Punues duke u bazuar në legjislationin në fuqi u dakordua që projekt-buxheti 2026 dhe parashikimet e buxhetit për vitin 2027-2028 të dalë në diskutim publik për qytëtarët, përfaqësuesit e fshatrave, OJQ-të, komunitetet e ndryshme, gratë, pensionistët, të rinjtë dhe studentët, bizneset, përfaqësues nga institucione të ndryshme, asamblen komunale dhe qytetarë pa dallim, për të marrur propozimet dhe brenda arsyeshmerisë së propozimeve të akomodohen në projekt-buxhetin 2026 dhe parashikimet e buxhetit për vitin 2027-2028. Njoftimi për organizimin e dëgjimeve buxhetore është ngarkuar në faqen zyrtare të komunës në internet, që qytetarët të bëhen pjesë e vendimmarrjes. Sipas kalendarit të publikuar në faqen zyrtare dhe rrjete të ndryshme sociale, janë mbajtur dëgjimet buxhetore.

## **KONSULTIMI PUBLIK**

Konsultimi publik u hap më 15.08.2025 me dokumentin i cili u publikua në platforma të ndryshme si dhe duke njoftuar publikun për procesin e konsultimit publik për projekt-buxhetin 2026 dhe parashikimet e buxhetit për vitin 2027-2028 për Komunen e Skenderajt dhe mundësinë e tyre për të dhënë komente dhe sygjerime edhe ne emailet zyrtare.

Publikimi në webfaqen zyrtare të Komunës dhe Facebook:

Në faqen zyrtare:

<https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/08/Kalendar-i-Degjimeve-Buxhetore-2026.pdf>

Publikimi në Facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1Hd1WpdcVkl/>

## **KONSULTIMI PUBLIK ME QYTETARË**

Më datë: 29.08.2025 dhe 05.09.2025 sipas kalendarit të publikuar janë mbajtur dëgjimet buxhetore, të pranishëm kanë qenë qytetarë të ndryshëm.

<https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/09/400-01-0041500-25.pdf>

<https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/09/400-01-0042940-25-1.pdf>

Konsultimin publik e shpalli të hapur z. Ismet Aliu, Kryesues i Grupit Punues për dëgjime buxhetore.

| Kërkesat / Sugjerimet / Komentet                                                                                                                                                                                       |  | Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Rushit Jeta:</b> Përhëndetje, projekti për tribunat e stadiumit të qytetit 75 mijë Euro janë planifikuar, a është tash përgjegjësi e Komunës apo ne e dimë që është privatizu klubi dhe i kalon klubit kjo çështje? |  | <p><b>Ismet Aliu:</b> Në vitin 2026 janë të përfshira në projektet kapitale edhe tribuna. Është një kontratë e lidhur e cila duhet të përfundojë për pjesën të cilën e ka kontraktuar Komuna, ndërsa nga vitet e ardhshme sigurisht se nuk kanë kaluar të gjitha procedurat e privatizimit të klubit dhe do të qartësohen të gjitha investimet që ka me i pas ai në raport me objektet sportive apo me pjesën e logjistikës.</p> <p><b>Pranohet</b></p> |
| <b>Rushit Jeta:</b> Është një rrugë e paasfaltuar në fshatin Tice diku me rreth 20 shtëpi dhe nëse kishit pasur mundësi ta planifikoni në buxhet.                                                                      |  | <p><b>Ismet Aliu:</b> Rrugën në Tice do të shikojmë mundësinë se a është ajo pjesa duke u banuar me qytetar, se shumë pjesë kanë mbetur vetëm shtëpitë e pabanuara, dhe normal aty ku është e arsyeshme të investohet Komuna menjëherë do të përkujdeset për realizimin e projekteve për me qenë të shfrytëzueshme.</p> <p><b>Pranohet</b></p>                                                                                                          |
| <b>Drita Mala:</b> A do të ndajë Komuna subvencione për bizneset e vogla?                                                                                                                                              |  | <p><b>Besarta Meha Ademi:</b> Drita siç po e shihni edhe në fletushkë është pjesa që është ndarë për subvencione për Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik.</p> <p><b>Pranohet</b></p>                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| <b>Xhevrije Thaçi:</b> Përhëndetje, unë kam hapur një biznes për prodhimin e lëngjeve bio dhe kam nevojë për mbështetje nga Komuna në mjete dhe në sigurimin e një objekti.                                            |  | <p><b>Besarta Meha Ademi:</b> Znj. Xhevrije duhet t'i përcillni thirrjet të cilat janë publike ku thirrjet zakonisht janë për biznese të vogla dhe të mesme. Të gjitha grantet që i kemi dhënë deri sot kanë qenë</p>                                                                                                                                                                                                                                   |

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | vetëm për sigurim të pajisjeve, jo edhe pjesën e ndërtimit.                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | <b>Pranohet</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <b>Muhamet Bajrakatari:</b> Përhëndetje, a keni planifikuar diçka për fermerët që merren me kafshët qumështore?                                                                                                                                                                                                              | <b>Ismet Aliu:</b> Ne si ekzekutiv zakonisht e planifikojmë një buxhet edhe në lëmin e bujqësisë, veç e kemi planifikuar, drejtori është kompetent se në cilat fusha dhe shpalljet dhe cilat kanë me qenë kriteret për përfitues. Por megjithatë buxhet ka mjaftueshëm edhe vitin e ardhshëm siç ka pasur edhe në këto vite dhe vitet e kaluara. |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | <b>Pranohet</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <b>Alketa Mecini:</b> Përhëndetje për të gjithë. Unë kam një propozim për vitin 2026 që të hyjë një poligon sportiv i përmasave të vogla në Klinë të Epërme në lagjen Mecini, pasi që ka shumë të rinj dhe nuk kanë hapësira për aktivitete sportive. Është një shumë simbolike dhe besoj është e përballueshme për Komunën. | <b>Ismet Aliu:</b> Çdo projekt i cili hyn në buxhet duhet t'i ketë edhe kost-benefitet e veta, me çka kuptojmë se kur investojmë në një pjesë 200,000 apo 300,000 € duhet të shikojmë se çka mbulojmë në atë pjesë të territorit.                                                                                                                |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | <b>Në shqyrtim</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | Do të shikojmë nevojën e qytetarëve për atë poligon dhe në bazë të arsyeshmërisë do të bëhet planifikimi.                                                                                                                                                                                                                                        |
| <b>Liridona Koci:</b> Një kërkesë që dua ta bëj është ndërtimi dhe riparimi i rrugëve në bashkësinë lokale të Polacit, ku kërkoj që kjo kërkesë të merret parasysh dhe të realizohet.                                                                                                                                        | <b>Ismet Aliu:</b> Riparimi i rrugëve ne i kemi disa kode edhe pse nuk është i cekur një fshat, ne kemi të drejtë të bëjmë riparimin e rrugëve aty ku ka nevojë.                                                                                                                                                                                 |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | <b>Pranohet</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <b>Kushtrim Dragaj:</b> Deshta të informohem rreth ndriçimit publik në qytet dhe bashkësi lokale. A do të përfshihet bashkësia lokale e Runikut vitin 2026                                                                                                                                                                   | <b>Ismet Aliu:</b> Ndrëimi publik është i paraparë në të gjitha bashkësit lokale.                                                                                                                                                                                                                                                                |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | <b>Pranohet</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                                                                                                                      |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Besart Rrecaj:</b> Sa i përket projektit të ndërtimit të bibliotekës dhe muzeut, po shoh që është një shumë prej 150,000 ku nuk është një shumë që mund të finalizohet, se me këto mjete nuk mund të kryhet as ndërtimi i vrazhdë. A kish me qenë më mirë që të pritet edhe një vit dhe të përfundohet komplet? | <b>Ismet Aliu:</b> Në fletushkë janë vetëm planifikimet për një vit, në buxhet janë të parapara shuma për tre vitet. |
| <b>Pranohet</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |                                                                                                                      |

Komente janë dhënë gjithsej nënte (9) komente, prej të cilave 8 janë pjesë e projekt-buxhetit 2026 dhe parashikimet e buxhetit për vitin 2027-2028.

| <b>Tema</b>                                                             | <b>Zyra</b>       | <b>Vendi<br/>Data</b>                                                                                                                                                           | <b>Komentet</b>                                                      | <b>1.Njofimi<br/>2.Procesverbal</b>                                                                                                                                                |
|-------------------------------------------------------------------------|-------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| projekt-buxheti 2026 si dhe parashikimet e buxhetit për vitin 2027-2028 | Zyra për Informim | <a href="https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/08/20250827091307.pdf">https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/08/20250827091307.pdf</a>           | Nënte (9)                                                            | 1. <a href="https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/08/20250827091307.pdf">https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/08/20250827091307.pdf</a>           |
|                                                                         | Zyra e Kuvendit   | <a href="https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/09/400-01-0042940-25-1.pdf">https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/09/400-01-0042940-25-1.pdf</a> | Nënte (8) komente janë marrë për bazë dhe një (1) është në shqyrtim. | 2. <a href="https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/09/400-01-0042940-25-1.pdf">https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/09/400-01-0042940-25-1.pdf</a> |
|                                                                         |                   |                                                                                                                                                                                 |                                                                      | <a href="https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/09/400-01-0041500-25.pdf">https://skenderaj.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/09/400-01-0041500-25.pdf</a>        |

Ashtu siç është bërë edhe njofimi publik për qytetarët, të njëjtit kanë pasur mundësi që komentet, vërejtjet apo sugjerimet e ndryshme t'i japin edhe në mënyrë elektronike tek emailet zyrtarë. Mirëpo asnjë koment nuk është pranuar në mënyrë elektronike për këtë projekt-buxhetin 2026 dhe parashikimet e buxhetit për vitin 2027-2028.

Grupi Punues takimin e fundit e ka mbajtur me datë 05.09.2025 në të cilin janë diskutuar komentet e mbledhura. Kryesuesi i Grupit Punues, z. Ismet Aliu ka thënë që nënte (8) komente që janë dhënë gjatë fazës së konsultimit publik janë të përfshira dhe janë pjesë e tij. Meqë faza e konsultimit publik ka përfunduar, atëherë unë në emër të këtij komisioni, një raport mbi procesin e konsultimit publik do të ja dërgoj Kryetarit të Komunës

#### **Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:**

Vendimi për caktimin e Grupit Punues

Njofimin publik për konsultimin publik








Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo

REPUBLIC OF KOSOVO  
MUNICIPALITY OF SKENDERAJ  
SKENDERAJ

Nr. 02-400/61-0035007/25  
Data. 15. 08. 2025



Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

## Kalendari i dëgjimeve buxhetore publike me qytetarë për buxhetin e vitit 2026

u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Skenderajt, dhe nenit 31 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, i Komunës së Skenderajt, Fadil Nura dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me Zyren e Informimit Publik dhe Komitetin për Organizimin e dëgjimeve buxhetore me qytetarë për hartimin e buxhetit për vitin 2026.

Dëgjime buxhetore do të mbahen me datë 29 Gusht 2025 sipas kalendarit të detajuar. Në këto dëgjime do të marrin pjesë: qytetarët, përfaqësuesit e fshatrave, OJQ-të, komunitetet e ndryshme, gratë, të rinjtë dhe studentët, bizneset, përfaqësues nga institucione të ndryshme dhe qytetarë të tjerë pa kufizime kontributiv e tyre në hartimin e buxhetit për vitin 2026.

| Nr | Dëgjimi buxhetor me qytetarë                                                                                                     | Dita/data e mbajtjes së dëgjimit buxhetor | Vendi i mbajtjes                    | Ora   |
|----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|-------------------------------------|-------|
| 1  | Dëgjimi buxhetor me grupet e grave, studentët dhe të rinjtë, pensionistët, personat me aftësi të kufizuara dhe qytetarë të tjerë | E premte, 29 Gusht 2025                   | Salla e Kuvendit Komunal, Kati i IV | 10:00 |
|    | Dëgjimi buxhetor me përfaqësuesit e bizneseve dhe fermerët e komunës së Skenderajt                                               | E premte, 29 Gusht 2025                   | Salla e Kuvendit Komunal, Kati i IV | 11:00 |
|    | Dëgjimi buxhetor me grupet e interesit (biznese, shoqërië civile, klube sportive, artistët, qytetarë të tjerë)                   | E premte, 29 Gusht 2025                   | Salla e Kuvendit Komunal, Kati i IV | 14:00 |

|   |                                                                                                        |                             |                                           |       |
|---|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|-------------------------------------------|-------|
| 4 | Dëgjimi i përgjithshëm<br>buxhetor me përfaqësues të<br>lagjeve dhe fshatrave dhe<br>qytetarë të tjerë | E premte, 29<br>Gusht 2025  | Salla e Kuvendit<br>Komunal, Kati i<br>IV | 15:00 |
| 5 | Dëgjimi i përgjithshëm<br>buxhetor i organizuar nga<br>Kuvendi Komunal                                 | E premte, 5<br>shtator 2025 | Salla e Kuvendit<br>Komunal, Kati i<br>IV | 14:00 |

Për më shumë detaje, për Qarkoren buxhetore përmes të cilës hartohet Propozim-buxheti për Komunën e Skenderajt mund të vizitoni vegëzën e mëposhtme:

Faqen zyrtare të komunës në internet në rubrikën e konsultimeve publike:

<https://skenderaj.rks-gov.net/shpalljet/?tax=diskutimet-publike>

Komentet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni në emailat: [ismet.aliu@rks-gov.net](mailto:ismet.aliu@rks-gov.net) dhe [eton.rushiti@rks-gov.net](mailto:eton.rushiti@rks-gov.net).

Udhëheqës i Zyrës për Informim



Amir Lushitaku



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo

Nr. \_\_\_\_\_  
No. 02-220/01-0008208/25  
Data. \_\_\_\_\_  
Data. 06.03.2025



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit / Kabinet Prcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 13, nenit 58 pika a) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, ndërlidhur me nenin 37 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 15 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.110-385, të datës 03.12.2008, mbështetur në Udhëzimin Administrativ (MAPL) NR.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, Kryetari i Komunës merr këtë:

## V E N D I M

(Për themelimin e Grupit Punues)

### I. Themelohet Grupi Punues Përgjegjës për Dëgjime Buxhetore, në këtë përbërje:

1. Ismet Aliu – Drejtor për Buxhet dhe Financa. kryesues;
2. Besart Geci – Zyrtar Kryesor Financiar, anëtar;
3. Amir Lushtaku – Udhëheqës i Zyrës për Informim, anëtar;
4. Driton Mula – Drejtor për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, anëtar;
5. Besarta Meha- Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik, Ndërmarrësi, Inovacion dhe Turizëm, anëtare;
6. Behxhet Maliqi – Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar;
7. Kastriot Duraku – Drejtor i Drejtorisë për Arsim, anëtar;
8. Shahin Tahiri – Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, anëtar;
9. Alban Berisha – Drejtor për Kulturë Rini dhe Sport, anëtar;
10. Alban Shala – Drejtor për Shërbime Publike, anëtar.

- II. Detyrë e grupit punues nga pika I e këtij vendimi është identifikimi i grupeve të qytetarëve, përgatitja e planit të dëgjimeve buxhetore, materialeve dhe informacioneve të nevojshme, pastaj prezantimi i informacioneve të buxhetit, ndarja e listave të pjesëmarrësve, moderimi i takimeve, përpilimi i kriterëve për shqyrtimin e kërkesave, shqyrtimi i kërkesave, hartimi i raportit përfundimtar dhe publikimi i raportit të konsultimeve publike në faqen e internetit të komunës, sipas afateve të përcaktuara me UA për Administratë të Hapur në Komuna.

- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit
- Kryesuesit të grupit punues
- Anëtarëve të grupit punues

